



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

LEGJISLATURA V

Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim

Mbledhja nr. 34.

Prishtinë, më 16.02.2016 në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-302

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim

Në mbledhje morën pjesë: Jasmina Zhivković, Agim Çeku, Agim Kikaj, Milka Vuletiq, Sasha Milosavljeviq, Slavko Simiq, Danush Ademi dhe Veton Berisha .

Munguan: Mufera Shinik, Fisnik Ismaili, Rustem Berisha dhe Qerim Bajrami

Pjesëmarrës të tjerë në mbledhje : Saniye Berisha- përfaqësuese nga OSBE-ja, Albert Krasniqi- përfaqësues nga KDI-ja, Zijush Ahmeti -konsulltant i Sekretariatit të KKK dhe Celal Iliaz, nga Drejtoria për Media dhe Marrëdhënie me Publikun.

Stafi mbështetës i Komisionit: Natasha Prica-Tishma dhe Drita Çarkaxhiu.

Mbledhjen e kryesoi: **Jasmina Zhivković**, kryesuese e Komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua, ky rend i ditës:

1. **Miratimi i rendit të ditës;**
2. **Miratimi i procesverbaleve në mbledhjet e mbajtura, më: 8.12.2015, 27.01.2016 dhe 29.01.2016;**
3. **Shqyrtimi i Projektligjit nr.05/L-31 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, me amendamente të Komisionit funksional për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media;**
4. **Shqyrtimi i Projektligjit nr.05/L-060 për Mjekësinë Ligjore, me amendamente të Komisionit funksional për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikqyrjen e Agjencisë kundër Korrupsionit;**
5. **Shqyrtimi i Projektligjit nr. 05/L-049 për administrimin e pasurisë së sekuestruar dhe të konfiskuar, me amendamente të Komisionit funksional për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikqyrjen e Agjencisë kundër Korrupsionit;**
6. **Shqyrtimi i Projektligjit nr. 05/L-062 për Siguri në Punë në Veprimtarinë Minierave, me amendamente të Komisionit funksional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri;**
7. **Të ndryshme.**

1. Miratimi i rendit të ditës;

Kryesuesja, konstatoi se rendi i ditës u miratua, pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbaleve në mbledhjet e mbajtura, më: 8.12.2015, 27.01.2016 dhe 29.01.2016;

Kryesuesja, konstatoi se Komisioni miratoi procesverbalet e mbledhjeve të mbajtura më 8.12.2015, 27.01.2016 dhe 29.01.2016, pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Projektligjit nr.05/L-31 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, me amendamente të Komisionit funksional për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media;

Kryesuesja, paraqiti për shqyrtim Projektligjin nr.05/L-31 për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe kërkoi nga anëtarët e komisioni të deklarohet, nëse ka ndonjë propozim në amendamente, në mënyrë që vërejtjet të përfshihen në rekomandimin, i cili do t'i dërgohet Komisionit Funksional.

Pas diskutimeve në Projektligj dhe Raportin e Komisionit Funksional me amendamente të propozuara, Komisioni nxori këtë:

Rekomandim

- I. Komisioni për të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, ka shqyrtuar Projektligjin nr.05/L-31 për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe konstatoi se projektligji nuk cenon dhe nuk prek të drejtat dhe interesat e komuniteteve.
- II. Projektligji me amendamentet e propozuara nga Komisioni Funksional, mund të procedohet për shqyrtim dhe miratim në mbledhje plenare të Kuvendit.

4. Shqyrtimi i Projektligjit nr.05/L-060 për Mjekësinë Ligjore, me amendamente të Komisionit funksional për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikqyrjen e Agjencisë kundër Korrupsionit;

Kryesuesja, paraqiti për shqyrtim Projektligjin nr.05/L-060 për Mjekësinë Ligjore, me raport amendamente të Komisionit Funksional dhe vlerësoi se nuk ka vërejtje apo sugjerime nga anëtarët e Komisionit.

Me që nuk pati vërejtje në Projektligj dhe Raportin e Komisionit Funksional me amendamente të propozuara, Komisioni nxori këtë:

Rekomandim

- I. Komisioni për të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, ka shqyrtuar Projektligjin nr.05/L-060 për Mjekësinë Ligjore dhe konstatoi se projektligji nuk cenon dhe nuk prek të drejtat dhe interesat e komuniteteve.
- II. Projektligji me amendamentet e propozuara nga Komisioni Funksional, mund të procedohet për shqyrtim dhe miratim në mbledhje plenare të Kuvendit.

5. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 05/L-049 për administrimin e pasurisë së sekuestruar dhe të konfiskuar, me amendamente të Komisionit funksional për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikqyrjen e Agjencisë kundër Korrupsionit;

Kryesuesja, paraqiti për shqyrtim Projektligjin nr. 05/L-049 për administrimin e pasurisë së sekuestruar dhe të konfiskuar, me raport amendamente të Komisionit Funksional dhe vlerësoi se nuk ka vërejtje apo sugjerime nga anëtarët e Komisionit.

Me që nuk pati vërejtje në Projektligj dhe Raportin e Komisionit Funksional me amendamente të propozuara, Komisioni nxori këtë:

Rekomandim

- I. Komisioni për të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, ka shqyrtuar Projektligjin nr. 05/L-049 për administrimin e pasurisë së sekuestruar dhe të konfiskuar dhe konstatoi se projektligji nuk cenon dhe nuk prek të drejtat dhe interesat e komuniteteve.
- II. Projektligji me amendamentet e propozuara nga Komisioni Funksional, mund të procedohet për shqyrtim dhe miratim në mbledhje plenare të Kuvendit.

6. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 05/L-062 për Siguri në Punë në Veprimtarinë Minierave, me amendamente të Komisionit funksional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri;

Kryesuesja, paraqiti për shqyrtim Projektligjin nr. 05/L-062 për Siguri në Punë në Veprimtarinë Minierave, me raport amendamente të Komisionit Funksional dhe vlerësoi se nuk ka vërejtje apo sugjerime nga anëtarët e Komisionit.

Meqë nuk pati vërejtje në Projektligj dhe Raportin e Komisionit Funksional me amendamente të propozuara, Komisioni nxori këtë:

Rekomandim

- III. Komisioni për të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, ka shqyrtuar Projektligjin nr. 05/L-062 për Siguri në Punë në Veprimtarinë Minierave dhe konstatoi se projektligji nuk cenon dhe nuk prek të drejtat dhe interesat e komuniteteve.
- IV. Projektligji me amendamentet e propozuara nga Komisioni Funksional, mund të procedohet për shqyrtim dhe miratim në mbledhje plenare të Kuvendit.

Mbledhja përfundoi në orën 12:00

E përgatiti:

Njësia për mbështetjen e Komisionit

Kryetarja e Komisionit

Jasmina Zhivković